



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 380 /2026
Data: 13.01.2026

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e dhjetë -X- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 30.12.2025 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: **Mehmet Ballazhi** (Kryetarë i Komunës), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Senad Kalisi** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Bajrush Laçi** (Udhëheqës i Zyrës Ligjore).

RENDI I PUNËS

1. Betimi i anëtarëve të ri të kuvendit të komunës.
2. Propozim vendimi për përbërjen e komitetit për politik e financa.
3. Propozim vendimi për përbërjen e komitetit për komunitete.
4. Propozim vendimi për përbërjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
5. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim rendin e punës; rezultati i votimit ishte njëzëri,

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Betimi i anëtarëve të ri të kuvendit të komunës.

Kryesuesi thekson:- ftoj me radhë anëtarët e rinj që ta lexojnë tekstin e betimit.

Ibadete Kuka thekson:- betohem se do t'i kryej me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si këshilltar i kuvendit të komunës së Hanit të Elezit , në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë.

Hanumshahe Dibrani thekson:- betohem se do t'i kryej me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si këshilltar i kuvendit të komunës së Hanit të Elezit , në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë.

2. Propozim vendimi për përbërjen e komitetit për politik e financa.

Kryesuesi thekson: në Komitetin për Politikë e Financa secila parti duhet të propozojë nga një anëtar, duke pasur parasysh edhe respektimin e kuotës gjinore. Para se të fillohet me propozimin e anëtarëve, kërkoj që të marrim një pauzë dhjetë (10) minuta me shefat e grupeve parlamentare, që të konsultohemi për çështjen e anëtarëve. Pas konsultës që patëm me shefat e grupeve parlamentare, kërkoj që të japin propozimet e tyre.

Basri Dernjani thekson: në emër të Partisë Demokratike, për anëtare të Komitetit për Politikë e Financa propozojmë znj. Sejlane Dernjani.

Sead Vila thekson: në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, për anëtare të Komitetit për Politikë e Financa propozojmë znj. Medina Imishti.

Sherif Bushi thekson: në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, për anëtar të Komitetit për Politikë e Financa propozojmë z. Menduh Vlashi.

Ibadete Kuka thekson: në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, për anëtar të Komitetit për Politikë e Financa propozojmë z. Visar Hasallari.

Kryesuesi thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROPOZIM-VENDIMI PËR PËRBËRJEN E KOMITETIT PËR POLITIKË E FINANCA

3. Propozim vendimi për përbërjen e komitetit për komunitete.

Kryesuesi thekson: ftoj grupet parlamentare që t'i propozojnë emrat për anëtarë të Komitetit për Komunitete.

Basri Dernjani thekson: në emër të Partisë Demokratike, për anëtar të Komitetit për Komunitete propozoj z. Basri Dernjani. Në emër të shoqërisë civile propozoj z. Erblin Meliqi.

Medina Imishti thekson: në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, për anëtar të Komitetit për Komunitete propozojmë z. Sead Vila.

Menduh Vlashi thekson: si Aleancë jemi dakorduar që në këtë komitet të jetë një anëtar prej komuniteteve. Emrin do t'ua përcjellim sot apo nesër.

Visar Hasallari thekson: në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, për anëtare të Komitetit për Komunitete propozojmë znj. Ibadete Kuka.

Kryesuesi thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROPOZIM-VENDIMI PËR PËRBËRJEN E KOMITETIT PËR KOMUNITETE

4. Propozim vendimi për përbërjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Kryesuesi thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mehmet Ballazhi thekson: sipas Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, Nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi duhet të ketë këtë përbërje: Kryetari i Komunës (kryesues), komandanti i stacionit të Policisë në komunën përkatëse, nga një përfaqësues legjitim i secilës bashkësi fetare të komunës përkatëse, nga një përfaqësues i secilit komunitet etnik të komunës përkatëse, kryesuesi i Komitetit për Komunitete të Kuvendit të Komunës, zyrtari për Barazi Gjinore, drejtori i Drejtorisë për Arsim, kryetari i Këshillit të Prindërve të Arsimit të komunës përkatëse, një përfaqësues i FSK-së, një përfaqësues i secilit Këshill Lokal për Siguri Publike, kryesuesi i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi, një përfaqësues nga sektori i emergjencave civile komunale, përfaqësuesi i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, një përfaqësues nga OJQ-të, mediat lokale, komuniteti i biznesit dhe komuniteti i personave me aftësi të kufizuara. Kërkoj që të miratohet ky propozim-vendim, pasi që sipas udhëzimit të cekur më lart jemi të obliguar që të themelohet ky këshill.

Kryesuesi thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROPOZIM-VENDIMI PËR PËRBËRJEN E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

5. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson: - për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Menduh Vlasi thekson: është mirë ta krijojmë njëfarë kulture dhe bindjeje se kur të thirret mbledhja në ora njëmbëdhjetë, kam dëshirë që në ora njëmbëdhjetë të fillojë mbledhja, dhe të mos krijohet një kulturë pune që mbledhja të fillojë me dhjetë apo pesëmbëdhjetë minuta vonësë.

Kryesuesi thekson: jo rastësisht morëm pauzë, por arsyen e kuptove edhe më herët. Është në rregull dhe çdo herë i kemi mbajtur mbledhjet në ora njëmbëdhjetë. Mirëpo ne jemi njerëz, duhet të diskutojmë dhe të dakordohemi për të ardhur këtu dhe për të arritur qëllimin për të cilin jemi të thirrur. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:45.

Procesmbajtësi

Ayni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta

